ILLYRIAN GUARD Sh.A

SPECIFIKIMET TEKNIKE

# "LCD WALL"

## 1. HYRJE

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Autoritet Kontraktues : **Illyrian Guard Sh.A**

### 1.2. Historiku

*"Illyrian Guard" sh.a është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 4 Prill 2019, si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror, për ofrimin e shërbimeve ndaj personave fizikë e juridikë, publikë dhe privatë. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 % të aksioneve të shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a., është Ministria e Brendshme. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., ofron shërbime mbështetëse në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj, në zbatim të kompetencave që i njihen kësaj të fundit sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore. Mënyra e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime*

*të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie, për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike. "Illyrian Guard" vjen si një alternativë e re në treg, duke garantuar*

*profesionalizëm, cilësi maksimale si dhe sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit. Përdorimi i teknologjisë së avancuar dhe infrastruktura kontribuon në ofrimin e një shërbimi me cilësi të lartë dhe garanton konfidencialitetin e informacionit. Në fokus të Shoqërisë janë gjithashtu kërkimet teknologjike të thelluara në funksion të sigurisë fizike dhe kibernetike.*

- ***Qëllimi i Illyrian Guard Sh.A është të implementojmë sistemet më të avancuara ndërkombëtare në funksion të ruajtjes dhe të krijojmë partneritet me kompanitë lider në botë.***

## 2. QËLLIMI I PUNËS

### 2.1. Të Përgjithshme

- Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" ;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 " Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- VKM Nr.177, datë 04.04.2019 " Për krijimin e shoqërisë "Illyrian Guard" SH.A"
- VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore".

- Të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale në respekt të Legjislacionit për Mbrojtjen e te Dhënave Personale dhe në veçanti të Nenit 27 "Masat e sigurisë për të dhënat personale" dhe Nenit 28 "Konfidencialiteti i të dhënave" të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimeve dhe vendimeve te miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

# KËRKESAT FUNKSIONALE

1. Operatori ekonomik fitues duhet të realizoje instalimin dhe konfigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për këtë projekt.
   - Përsa i përket konfigurimeve është detyrë e operatorit ekonomik fitues kryerja e të gjitha instalim/montim/konfigurim të nevojshëm përsa i përket:
     a. Zbatimin e Projektit
     b. Montim/Konfigurim LCD Video Wall
     c. Montim/Konfigurimi i Dekoder Video Wall
     d. Konektimi i Video Wall/Dekoder me paisjet kompjuterike që ka aktualisht Illyrian Guard Sh.A

2. Garancia e ofruar për pajisjet fizike do të jete sipas modelit te secilës pajisje, të përcaktuar më poshtë në specifikimet teknike.
3. Çdo pajisje dhe material poshtë përmendura duhet të jetë FV "Furnizim Vendosje".
4. Ofertuesi i shërbimit në rast se nevojitet të jetë i gatshëm për zhvendosjen fizike të LCD WALL-it bashkë me Aksesorët përkatëse brënda afatit të garancis, kur kjo të kërkohet nga Illyrian Guard Sh.A. Realizimi i zhvendosjes duhet kryer në afat kohor jo më shumë se 5 ditë kalendarike , duke mos ndikuar në aktivitetin e Illyrian Guard Sh.A, Gjithashtu AK shprehet se: Zhvendosja fizike e Pajisjeve në fjalë do të ndodhi vetëm në rastet emergjente kur të kërkohet nga Illyrian Guard Sh.A .
5. Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Qëndra e Vëzhgimit dhe Drejtimit për përdorimit e LCD WALL .

❖ Përshkrimi i Projektit

a) Dizenjimi i LCD WALL-it do të jet i ndarë në 3 (tre) kategori ku përfundimi do të jenë një trup si në fotot e projektit më poshtë Specifikimeve Teknike dhe të shpjeguara në **fig.2.**
b) LCD-WALL-i do jetë i ndarë me 3 Kontroller Dekoder, secili me menaxhim më vete dhe të pavarur nga njëri tjetri .
c) Kontroller decoder do të jetë i instaluar/konekuar me kompjuterat WorkStation/Servera që ka aktualisht Illyrian Guard Sh.A .
d) Në të gjithë projektin e LCD Wall-it do të lejohet toleranca, + dhe - (pesë) 5% (përqind) të Lartësis dhe Gjërësis së LCD WALL-it, pasi në ambientet e Illyrian Guard Sh.A ku do të instalohet ky Projekt bënë të mundur tolerancën përshkak të hapsirës së madhe dhe kushteve që disponon.
e) Distanca nga LCD WALL-i deri në Dhomën e Serverit ku janë të instaluar Workstation/Server e Shoqeris Illyrian Guard Sh.A është nga 23 deri 28 meter duke llogaritur dhe tolerance e kabujve 2/3 metër.
f) Bazamenti do të jetë i shtrirë në të gjithë siperfaqen e LCD-WALL-it ku do të vendoset me një distanc gjërësi: 70-110cm ku dhe do të krijohet mundësia që të jetë i aksesueshëm pjesa mbrapa e LCD WALL-it, hapësira fillon nga muri deri tek fundi i bazamentit .

g) LCD-WALL-i duhet të konektohen me dekoderin përkatës sipas Projektit më poshtë, ku duhet të përshtaten portat e LCD Wall-it me Dekoderin sipas modelit që do të ofrojë OE, Përshembull : HDMI/DP/DVI/VGA/RJ45/mDP ose të tjera

h) **(W) Gjërësi, (H) Lartësia totale e LCD WALL do të jetë (W) = 7254mm (H)=2040mm**

○ **Lista e Pajisjeve Elektronike dhe Aksesorëve që nevojiten për realizimin e këtij Projekti.**

| **Numrat e renditur sipas specifikimeve më poshtë** | **Emertimet** |
|---|---|
| **1.** | Ekran LCD 55 inch |
| **2.** | LCD-Wall Kontroller “Decoder” |
| **3.** | Kabuj konektimi 23 deri 30 Meter Cilesia 4K për lidhnjen e LCD Wall-it me dekoderin përkatës, dhe me paisjet Kompjuterike të AK-s ,<br>si:  HDMI/DVI/DP/VGA/Rj45/mDP/ dhe Adaptor. |
| **4.** | Kabuj konektimit të LCD-Wall-it për të realizuar lidhjen mes tyre, gjatësia e kabujve që do përdoren mbrapa LCD Walli-t duhet të jetë në varësi të distances së ekraneve,Modeli kabujve : HDMI/DVI/DP/Rj45/mDP/Adaptor ose të tjera |
| **5.** | Bazament Metalik duhet ti përshtatet me dimensionet e LCD wall-it “ (W) Gjërësi (H) Lartësi”  + dhe -  (pesë)  5%  (përqind) si në pikën 4 të Projektit<br>Fig.1/Fig.2/Fig.3 |

1. LCD-WALL

| **Karakteristikat** | **Vlerat Specifike Minimale** |
|---|---|
| a. Contrasti | a) Minimumi 1000:1 |
| b. Rezolucioni | b) Min. 1920-1080 50 ose 60 Hz |
| c. Temperatura e Operimit | c) Min. 0 + 40  °C |
| d. Temperatura e Memorjes “Storage Temperature” | d) Min. - 10 + 50 °C |
| e. Voltazhi | e) Min. 100-240VAC |
| f. “Working Humidity” /Lagështia e punës | f) Min. 10% ~ 70% RH |
| g. Lagështia e Ruajtjes/ “Storage Humidity” | g) Min. 10%~70% RH |
| h. Video & Audio input | h) Minimimi VGA × 1, HDMI × 1, DVI × 1, DP × 1, USB × 1 |
| i. Video & Audio Output | i) Minimumi 1x HDMI |
| j. Thellësia e ngjyrave | j) Minimumi 8 bit, 16.5 M |
| k. Response time | k) Min.8ms |
| l. Backlight | l) Direct LED |
| • Garancia | ✓ 3 vjet |

2. DECODERI I LCD WALL-IT

| **Karakteristikat** | **Vlerat Specifike Minimale** |
|---|---|
| a. Portat | a. Decoderi duhet të konektohen me LCD-Walli-n sipër pwrmendur dhe sipas projektit më poshtë ku portat që duhet të ketë për kokektimin me LCD-Wall-in janë pwrshembull :  HDMI/DP/DVI/VGA/RJ45/mDP dhe Adaptor ose tw tjera. |
| b. Menaxhimi | b. Menaxhimi i LCD-Wall-it do të kryhet nga Web ose program përkatës. |
| c. Network | c. 10/100/1000 Mbps Ethernet interface. |
| • Garancia | ✓ 3 vjet |

<u>**Projekti Fig.1/Fig.2/Fig.3**</u>




**Fig. 2**



**Fig. 3**


Bazameti i LCD WALL Fig.3
Murë
2040mm
(H) Lartësia
Distanca
70-110cm
(W) Gjërësia
7254mm
Bazamenti do të jetë i shtrirë në të gjithë siperfaqen e LCD-WALL-it ku do të vendoset me një distanc gjërësi: 70-110cm ku dhe do të krijohet mundësia që të jetë i aksesueshëm pjesa mbrapa e LCD WALL-it, hapësira fillon nga muri deri tek fundi i bazamentit,